



Bashkë-financuar
nga Bashkimi Evropian

Bashkë-financuar nga Agjensia
Ndërkombëtare Suedeze për
Zhvillim dhe Bashkëpunim



Sweden
Sverige

DOKUMENT POLITIKASH GJINIA DHE MJEDISI NË SHQIPËRI

Shtator 2022



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Bashkë-financuar
nga Bashkimi Evropian

Bashkë-financuar nga Agjensia
Ndërkombëtare Suedeze për
Zhvillim dhe Bashkëpunim



Sweden
Sverige

Ky Dokument Politikash është hartuar në kuadrin e projektit "***Krijimi i Aleancave Lokale Feministe Mjedisore***", që implementohet nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe mbështetet nga Reactor - Research in Action dhe partnerët e tyre përmes Aksionit "***Përparimi i Barazisë Gjinore përmes Procesit të Anëtarësimit në BE***". Ky Aksion financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe është bashkëfinancuar nga Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian apo të Agjensisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Përgatitur nga:
Qendra EDEN
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Tabela e Përmbajtjes

DOKUMENT POLITIKASH	1
GJINIA DHE MJEDISI NË SHQIPËRI	1
SHKURTIME	4
MESAZHET KRYESORE	5
HYRJE	6
OBJEKTIVI	9
BARAZIA GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE NË SHQIPËRI	10
KUADRI LIGJOR	12
NIVELI NDËRKOMBËTAR	12
NIVELI KOMBËTAR:	13
REKOMANDIME:	17
TEK ORGANET QEVERITARE DHE AUTORITETET LIGJORE.....	17
ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE.....	18
KOMUNITETI I DONATORËVE.....	18
SHEMBUJ FRYMËZUES:	18
REFERENCAT	19

Shkurtime

AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave
COP	Konferenca e Palëve
GCF	Fondi Global i Klimës
GEP	Plani i Barazisë Gjinore
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Masat kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
INSTAT	Instituti i Statistikave në Shqipëri
ISID	Zhvillim Industrial Gjithëpërfshirës dhe i Qëndrueshëm
KKKBNK	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
MARD	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
NDC	Kontributi Kombëtar i Përcaktuar
OZHQ	Objektiv i Zhvillimit të Qëndrueshëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PKBM	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
SKZNK	Strategjia Kombëtare për Zbutjen e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SZHBI	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve

Mesazhet kryesore

- Gratë janë aktore aktive në ndryshimet klimatike dhe në sektorin e mjedisit. Rolet, shqetësimet dhe kontributet e tyre të përcaktuara nga gjinia në shtëpi, komunitet dhe në vendin e punës duhet të njihen dhe të pasqyrohen në politikat dhe veprimet përkatëse.
- Ekziston nevoja për rritje të ndërgjegjësimit dhe rritje kapacitetesh sa i përket aspekteve të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave në vend lidhur me sektorin e mjedisit.
- Ky ndërgjegjësim duhet të përkthehet në angazhim politik dhe financim për veprime të përshtatshme që garantojnë ndjeshmëri gjinore në zhvillimet e lidhura me ndryshimet klimatike.
- Planifikimi dhe financimi i politikave dhe programeve duhet të lejojë integrimin e parimeve të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave në sektorët e lidhur me ndryshimet klimatike dhe mjedisin në të gjitha nivelet.

Hyrje

Qasja në një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm është më në fund një e drejtë universale e njeriut, e miratuar më 28 korrik 2022 nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së¹. Rëndësia e kësaj rezolute historike është se askush nuk mund të na e marrë natyrën, ajrin e pastër dhe ujin, ose një klimë të qëndrueshme – të paktën, jo pa luftë,². Në këtë kontekst, kjo rezolutë luan një rol në përpjekjen për ta bërë mjedisin më të shëndetshëm dhe më të qëndrueshëm dhe Shqipëria si nënshkruese e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut³ ka shansin ta përdorë këtë rezolutë për të garantuar mbrojtjen e mjedisit për qytetarët e saj.

Krahas ratifikimit të Konventës për të Drejtat e Njeriut më 2 tetor 1996⁴, Shqipëria ka legjislacion të fuqishëm në sektorin e mjedisit që përfshin një sërë strategjish, ligjesh, vendimesh të Këshillit të Ministrave dhe konventash⁵.

Që qytetarët të përmbushin detyrat e tyre dhe të fitojnë të drejtat e tyre njerëzore, së pari duhet të jenë të vetëdijshëm se çfarë ndodh me mjedisin që i rrethon dhe të jenë të vetëdijshëm për ligjin për akses në informacion⁶ dhe konventën e Aarhusit⁷. Kjo e fundit ka luajtur një rol të rëndësishëm në Shqipëri, veçanërisht për të drejtën për të marrë informacion mjedisor dhe akses në drejtësi. Pavarësisht një kuadri ligjor dhe politik të zhvilluar mirë, njerëzit, pavarësisht nga gjinia e tyre, shpesh e shohin veten si të pafuqishëm për të bërë ndryshimin në mënyrë që të minimizojnë ndikimet negative në mjedis. Ata nuk po e shfrytëzojnë plotësisht të drejtën për informim. Rrjedhimisht, qytetarët kanë prirjen të bëhen indiferentë ndaj kompleksitetit të sektorit mjedisor, deri në çastin kur natyra reagon fuqishëm me përmblytje, tërmete, valë të të nxehtit, etj., të cilat po bëhen më të shpeshta vitet e fundit dhe konsiderohen si një efekt anësor i ndryshimeve klimatike që janë të pranishme edhe në Shqipëri.

Shqipëria është një vend shumë dinamik dhe i përfshirë në një zhvillim të shpejtë urban, por ky zhvillim i shpejtë nuk është i qëndrueshëm dhe ka një kosto të konsiderueshme mjedisore. Rritja e konsumit të qytetarëve, nevoja për zhvillimin e transportit dhe infrastrukturës, rritja e prodhimit të mbetjeve urbane apo inerteve, derdhja e ujërave të zeza në dete dhe lumenj, prerja e paligjshme e pyjeve, erozioni i shtretërve të lumenjve, djegia e gomave të automjeteve, erozioni i maleve, ndërtimet e pakontrolluara etj. janë vetëm disa nga fatkeqësitë mjedisore me të cilat po përballet Shqipëria.

Krahas çështjeve të mësipërme, një nga temat më delikate në Shqipëri dhe në mbarë botën është kriza klimatike dhe energjetike me ndikimet e saj negative në aspektet ekonomike, sociale dhe mjedisore. Ndryshimet klimatike dhe energjia në Shqipëri janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën

¹ Asambleja e Përgjithshme e OKB deklaroi qasjen në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm si një të drejtë universale të njeriut <https://news.un.org/en/story/2022/07/1123482>

² Inger Andersen, Drejtore Ekzekutive e Programit Mjedisor të OKB (UNEP) <https://www.unep.org/news-and-stories/story/historic-move-un-declares-healthy-environment-human-right>

³ Nënshkruesit e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut <https://sdg.humanrights.dk/en/instrument/signees/24>

⁴ Të Drejtat e Njeriut <http://www.euro-centre.eu/referencat/human-rights-2/>

⁵ Legjislacioni dhe strategjitë e mjedisit <https://turizmi.gov.al/strategjia-e-mjedisit/>

⁶ Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/160-2014-DL.pdf>

⁷ Konventa për Aksesin në Informacion, Pjesëmarrje Publike në Vendimmarrje dhe Aksesin në Drejtësi për Çështje Mjedisore *Ligji Nr. 8672 datë 26.10.2000 për ratifikimin e "Konventës për Aksesin në Informacion, Pjesëmarrje Publike në Vendimmarrje dhe Aksesin në Drejtësi për Çështjet Mjedisore"* <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200610114104Ligji%20p%20p%20C3%ABr%20ratifikimin%20e%20KONVENT%20e%20S%20S%20S%20C3%8B%20AARHUSIT.....pdf>

pasi Shqipëria e prodhon energjinë e saj elektrike 99.5% nga hidrocentralet⁸, gjë që e bën vendin të brishtë ndaj ndryshimeve atmosferike. Në 20 vitet e fundit, stinët po humbasin veçoritë klimatike, dimrat janë bërë më të butë dhe më të shkurtër, ndërsa vera po bëhet më e nxehtë dhe më e gjatë në kurriz të pranverës dhe vjeshtës. Kjo po shkakton mungesë uji dhe po ndikon në prodhimin e brendshëm neto të energjisë. Këto ndryshime në veçoritë klimatike janë një nga pasojat e ndryshimeve klimatike që ka pasur ndikim në Shqipëri, vend i cili është tepër i ndjeshëm ndaj variabilitetit dhe ndryshimeve klimatike, veçanërisht për burimet ujore, sektorin e bujqësisë, shëndetin publik, energjinë dhe zonat bregdetare. Shirat e dendur, përmytjet dhe erozioni i tokës vënë në rrezik si infrastrukturën urbane, ashtu edhe atë rurale⁹. Vlerësohet se mesatarisht 50,000 shqiptarë preken nga përmytjet çdo vit dhe ndikimi negativ vjetor në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) është rreth 200 milionë dollarë¹⁰.

Fatkeqësitë e lidhura me klimën nuk janë neutrale ndaj gjinisë dhe gratë e fëmijët janë ndër grupet me rrezik më të lartë. Faktorët kryesorë që ndikojnë në dallimet midis cenueshmërisë së grave dhe asaj të burrave ndaj rreziqeve të ndryshimeve klimatike përfshijnë dallimet me bazë gjinore në përdorimin e kohës; qasjen në asete dhe kredi, trajtimin nga institucionet zyrtare që mund të kufizojë shanset e grave, qasjen e kufizuar në diskutimet dhe vendimmarrjen e politikave, dhe mungesë të të dhënave të ndara sipas sekseve sa i përket ndryshimit të politikave¹¹. Në këtë kontekst, zbutja e ndryshimeve klimatike kërkon pjesëmarrjen aktive të grave. Shqipëria nuk mbledh dhe publikon rregullisht të dhëna mbi gjininë dhe mjedisin, ka pak raporte dhe studime për këtë temë.

Sipas Bankës Botërore¹² për sa i përket tendencave klimatike në ndryshim, Shqipëria është një nga vendet më të cenueshme në rajon. Gjatë 15 viteve të fundit janë vërejtur ndryshime në mot me rritjen e temperaturave, uljen e reshjeve dhe shpeshtimin e ngjarjeve ekstreme, si përmytjet dhe thatësitë¹³. Parashikimet tregojnë një ulje të reshjeve të verës me rreth 10% deri në vitin 2020 dhe 20% deri në 2050. Energjia dhe bujqësia janë dy sektorë që ndikohen negativisht nga ndryshimet klimatike¹⁴.

Gjatë viteve, Raportet e Komisionit Evropian e kanë vlerësuar Shqipërinë me progres të pakënaqshëm në lidhje me Ndryshimet Klimatike, të cilat qëndrojnë si një nënkapitull specifik brenda Kapitullit 27. Megjithatë, ka një ndryshim progresiv në Raportet e KE-së për 2020-ën dhe 2021-in, ku thuhet se *“Shqipëria ka arritur një nivel përgatitjeje në trajtimin e ndryshimeve klimatike, por harmonizimi me acquis është ende i kufizuar”*¹⁵

⁸ Bilanci i energjisë elektrike 2021 <http://www.instat.gov.al/media/9633/bilanci-i-energijs%C3%AB-elektrike-2021.pdf>

⁹ Profili i Rrezikut Klimatik: Shqipëria (2021): Grupi i Bankës Botërore <https://climateknowledgeportal.worldbank.org/sites/default/files/2021-06/15812-Albania%20Country%20Profile-WEB.pdf>

¹⁰ DW 10.05.2022. Shqipëri: GIZ protagonist në zbutjen e ndryshimeve klimatike <https://www.dw.com/sq/shqip%C3%ABri-giz-protagonist-n%C3%AB-zbutjen-e-ndryshimeve-klimatike/a-61741809>

¹¹ Njëjtë si nr. 9

¹² Ndryshimet Klimatike në Shqipëri Banka Botërore. <https://www.worldbank.org/en/country/albania/brief/climate-change-in-albania>

¹³ Po aty

¹⁴ Po aty

¹⁵ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021 https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021_en

Sipas Raportit të progresit të BE-së për vitin 2022¹⁶, statistikave mjedisore janë vetëm pjesërisht të harmonizuara me *acquis* të BE-së, ndërsa statistikave të energjisë janë të harmonizuara në mënyrë të moderuar. Instituti i Statistikave në Shqipëri (INSTAT) dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore prodhojnë statistika mujore dhe vjetore të energjisë për bilancet e mallrave për të gjitha produktet energjetike (lëndët djegëse) që përdoren në Shqipëri si dhe çmimet e energjisë elektrike për familjet dhe industrinë.¹⁷ Sipas gjetjeve të të njëjtit raport, llogaritë e flukseve të materialeve mjedisore janë të harmonizuara mirë me *acquis* të BE-së. Llogaritë e emetimeve në ajër, llogaritë e fluksit të energjisë fizike dhe taksat mjedisore sipas aktivitetit ekonomik mbeten pjesërisht në përputhje me kërkesat e BE-së. Statistikat e mbetjeve janë përmirësuar, por ende nuk janë të harmonizuara plotësisht. Të dhënat mbi mbetjet e paketimeve janë gjithnjë e më të rëndësishme pasi ato janë baza për një burim të ri të Buxhetit të BE-së mbi mbetjet e paketimeve plastike të paricikluara. Shqipëria tashmë mbledh të dhëna për mbetjet bashkiake.¹⁸

Shqipëria finalizoi dhe miratoi Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (SZHBI)¹⁹ 2021-2027 në korrik 2021. SZHBI përcakton kuadrin strategjik për politikën shqiptare të sipërmarrjes dhe industrisë, duke mbuluar zhvillimin e aftësive të Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, inovacionin, rritjen e qëndrueshme dhe kushtet për tërheqjen e investimeve të huaja. Është miratuar gjithashtu programi për Zhvillimin Industrial Gjithëpërfshirës dhe të Qëndrueshëm (ZHIGJQ)²⁰ 2020-2024, me tre shtylla kryesore: konkurrenca industriale dhe aksesimi në treg, punësimi produktiv dhe zhvillimi i sipërmarrjes, dhe energjia e qëndrueshme për përdorime produktive dhe menaxhim mjedisor.

Duke iu rikthyer edhe një herë Raportit të Progresit të BE-së për vitin 2022, përvoja e përket Axfordës së Gjellbër²¹ dhe lidhjeve të qëndrueshme, është gjetur gjithashtu se Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar për energjinë, mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Sipas raportit vendi ynë ka një nivel përgatitjeje në fushat e politikës së transportit dhe rrjeteve trans-evropiane dhe është arritur njëfarë progresi në zhvillimin e rrjeteve të transportit dhe energjisë. Shqipëria ka bërë përparim në mbrojtjen civile dhe është gati t'i bashkohet Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Unionit.²² Vendi ka bërë përparim të kufizuar në fushat e tjera të mbuluara nga ky grupim dhe përpjekjet për të adresuar çështjet me Kontrollin Shtetëror Portual dhe për të harmonizuar legjislacionin duhet të vazhdojnë. Është bërë përparim i kufizuar në harmonizimin e mëtejshëm me *acquis* të BE-së për menaxhimin e ujit, kimikateve dhe krimin mjedisor²³. Ndikimi i investimeve strategjike në biodiversitetin dhe mbrojtjen e natyrës kërkon vëmendje. Ky grupim dhe reformat e lidhura me të kanë lidhje të rëndësishme me Programin e Reformës Ekonomike të Shqipërisë, Planin Ekonomik dhe të Investimeve të Komisionit dhe Axfordën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor të miratuar nga Shqipëria në dhjetor 2020.²⁴

¹⁶ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022 https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

¹⁷ Po aty

¹⁸ Po aty

¹⁹ Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve: <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/Strategjia-e-Zhvillimit-t%C3%AB-Biznesit-dhe-Investimeve.pdf>

²⁰ Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial

https://open.unido.org/api/documents/18998180/download/Factsheet%20on%20CP%20Albania_2020.pdf

²¹ Grupimi 4: Agjenda e Gjellbër dhe Lidhjet e Qëndrueshme – Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022 Online: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

²² Po aty

²³ Po aty

²⁴ Po aty

Sipas UN Women, është shumë e mundshme që furnizimi, përdorimi dhe konsumi i energjisë ndikon ndryshe tek burrat dhe gratë dhe ndërthuret me faktorë të tillë si vendndodhja, mosha dhe statusi financiar. Energjia konsiderohet si një temë mashkullore dhe menaxhimi i shtëpisë është një përgjegjësi e grave²⁵. Kështu, varfëria energjetike mund të përkeqësohet nga ndryshimet klimatike, pasi ajo ndikon në konsumin e energjisë, mjetet e ngrohjes, shëndetin dhe cilësinë e përgjithshme të jetës, duke përfshirë këtu edhe periudhën e dimrit, të gjitha temat që zakonisht bien nën kompetencën e grave.

Objektivi

Ky dokument politikash do të tregojë se ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre nuk janë neutrale ndaj gjinisë. Për shkak të roleve të përcaktuara nga gjinia në shoqëri dhe modeleve tradicionale të marginalizimit, gratë janë ndër njerëzit që ka të ngjarë të mbajnë barrën më të rëndë të këtyre ndryshime dhe të përfitojnë më pak nga politikat dhe programet që i trajtojnë ato. Ky dokument politikash tregon gjithashtu se gratë nuk duhet të shihen si 'viktima'. Ato janë aktore kyçe në aksionet për ndryshimet klimatike dhe nevojat e njohuritë e tyre duhet të përdoren për të informuar hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave për ndryshimet klimatike. Ky dokument politikash do të trajtojë tre Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)²⁶:

1. **OBJEKTIVI 5: Barazia Gjinore – Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave**
2. **OBJEKTIVI 7: Energji e Përbalueshme dhe e Pastër – Sigurimi i qasjes në energji të përbalueshme, të sigurtë, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë**
3. **OBJEKTIVI 13: Aksion Klimatik – Marrja e masave urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe impaktet e tyre**

Qëllimi i këtij dokumenti politikash është të rrisë ndërgjegjësimin dhe të demonstrojë se si të integrohen parimet e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave në veprimet dhe politikat e lidhura me mjedisin dhe ndryshimet klimatike në Shqipëri. Audienca e synuar janë politikëbërësit në nivel kombëtar dhe lokal, autoritetet legislative dhe organizata të tjera joqeveritare që punojnë në këtë fushë.

²⁵ UN Women & UNDP (2016). Gender Brief Albania 2016. Pwrgatitur nga Monika Kocaqi, Ani Plaku dhe Dolly Wittberger. UN Women, Shqipëri. Online <https://albania.un.org/en/46623-albania-gender-brief-2016>

²⁶ Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm është lançuar nga Samiti i OKB-së në Nju Jork më 25-27 shtator 2015 dhe ka si synim t'i japë fund varfërisë në të gjitha format e saj <https://www.coe.int/en/web/programmes/un-2030-agenda>

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave në Shqipëri

Gratë përbëjnë më shumë se gjysmën e popullsisë së Shqipërisë (50,2 %) ²⁷ dhe luajnë një rol të rëndësishëm në nivel familjar, në ekonomitë rurale dhe urbane dhe në shoqëri në tërësi. Ka dallime midis grave dhe burrave, dhe këto reflektohen në kontributet e grave dhe burrave në punën prodhuese dhe riprodhuese, në punësimin dhe pagat formale dhe informale, në nivelet e varfërisë, nivelet e analfabetizimit, në aksesin e tyre dhe kontrollin mbi burimet natyrore, modelet e migrimit, si edhe në pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave në vendimmarrje në nivele të ndryshme. Sipas INSTAT, 18.8% e grave i përmbushin detyrat shtëpiake, krahasuar me vetëm 0.6% të burrave ²⁸. Ky ndryshim në përqindje tregon se gratë dhe burrat kanë qëndrime të ndryshme ndaj energjisë dhe qëndrime të ndryshme në familjen e tyre sa i përket mbrojtjes së mjedisit. Pabarazitë gjinore ndërmjet grave dhe burrave kontribuojnë në cenueshmëri të ndryshme dhe rrjedhimisht edhe në ndikime të diferencuara të fatkeqësive natyrore dhe ndryshimeve klimatike. Nga ana tjetër, gratë dhe burrat kanë kapacitete të ndryshme – njohuri, përvojë, aftësi dhe vizione – në trajtimin e këtyre sfidave dhe ndikimeve. Megjithatë, duhet theksuar se jo të gjitha gratë janë njësoj; ato nuk formojnë një grup të madh homogjen. Ekzistojnë dallime të rëndësishme sipas diferencuesve socialë dhe ekonomikë si moshë (gratë dhe vajzat), statusi social (të pasura apo të varfra), jetesë dhe përkatësia etnike (pjesëtare të shumicës apo të pakicave).

Ka një përpjekje nga qeveria shqiptare për të arritur barazinë gjinore përmes një sërë politikash dhe strategjish për fuqizimin politik, ekonomik dhe social të grave. ²⁹ Ligji për Barazinë Gjinore kërkon një përfaqësim të paktën 30% të grave në të gjitha organet legislative, ekzekutive, gjyqësore dhe në institucionet e tjera ³⁰. Ndërkohë, në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ³¹, i cili është i vetmi komision për mjedisin në Kuvendin e Shqipërisë, 2 nga 20 anëtarë janë gra ³².

Meqë ky dokument politikash fokusohet në OZHQ-të, Qeveria e Shqipërisë është gjithashtu plotësisht e përkushtuar për zbatimin e agjendës 2030 ³³. Përfshirja e OZHQ-ve në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI-II) ³⁴, duke përfshirë strategjitë sektoriale përkatëse dhe politikat e planet kombëtare, është thelbësore për zbatimin e suksesshëm të OZHQ-ve në Shqipëri dhe në kontekstin e procesit të integritimit evropian gjithashtu. Shqipëria është

²⁷ Census 2011 online <http://www.instat.gov.al/en/themes/censuses/census-of-population-and-housing/publikimet/2011/publications-of-population-and-housing-census-2011/>

²⁸ Gratë dhe Burrat në Shqipëri online (<http://instat.gov.al/kapitulli/t%C3%AB-drejtat-e-njeriut/pengesa-sociale-si-forma-diskriminimi-n%C3%AB-praktik%C3%AB/>)

²⁹ Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 Për barazinë gjinore në shoqëri https://www.mod.gov.al/images/PDF/barazia_gjinore_shoqeri.pdf

³⁰ Neni 15 Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 Për barazinë gjinore në shoqëri https://www.mod.gov.al/images/PDF/barazia_gjinore_shoqeri.pdf

³¹ Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin është përgjegjës për shqyrtimin e projektligjeve dhe projekt-vendimeve që i paraqiten Kuvendit, për kryerjen e studimeve mbi efektivitetin e ligjeve në fuqi, ndjekjen e implementimit të ligjeve dhe kontrollimin e veprimtarisë së ministrive dhe organeve të tjera qendrore, propozimin në Kuvend ose në Këshillin e Ministrave për marrjen e masave përkatëse, si dhe propozimin e projektligjeve, projekt-deklaratave ose projekt-rezolutave për miratim në Kuvend

³² Struktura e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin <https://www.parlament.al/Strukture?kategori=5&strukture=1015>

³³ Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm <https://www.coe.int/en/web/programmes/un-2030-agenda>

³⁴ Përfshirja e OZHQ-ve përmes Strategjisë Kombëtare për Integrim dhe Zhvillim 2015-2020 (SKZHIII) <https://albania.un.org/sites/default/files/2020-05/no.30-%20SDG%20mainstreaming%20through%20the%20National%20Strategy%20for%20Integration%20and%20Development%202015-2020%20%28NSDI%20II%29.pdf>

anëtare e bordit të Fondit Global të Klimës (FGK)³⁵, e përfaqësuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, zëvendës Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe me iniciativën e saj së fundi u krijua një grup jozyrtar grash në Bordin e FGK, i cili demonstroi se kontributi i grave dhe vajzave në agjendën e zbatimit të ndryshimeve klimatike është i domosdoshëm. Barazia gjinore dhe lidhja e grave në ndryshimet klimatike kanë rëndësi kyçe në përpjekjet globale sipas Angazhimeve Ndërkombëtare të OKB-së dhe Agjendës 2030³⁶.

Bazuar në të dhënat e INSTAT³⁷ për "OZHQ 5. Barazia Gjinore - Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave", për të kontribuar në arritjen e "5.5 Sigurimi i pjesëmarrjes së plotë dhe të efektshme të grave dhe mundësive të barabarta të tyre për udhëheqje në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike" përqindja e grave duhet të rritet për të arritur objektivin e OZHQ5 (të dhënat e disponueshme 2014 - 20.7% ishte përqindja e grave në parlament dhe në 2020 përqindja e grave në parlament ishte 29.5%). SDG 7, 7.1 "Deri në vitin 2030 siguroni akses universal në shërbime të përbalueshme dhe të sigurta të energjisë" Përqindja e popullsisë me akses në energji elektrike në vitin 2020 është 99,98%; edhe ky tregues duhet të rritet për të arritur objektivin për vitin 2030.

Sipas Përmbledhjes për Barazinë Gjinore në Shqipëri për vitin 2020³⁸, Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT) ka rritur përdorimin e treguesve gjinorë dhe ka shtuar seksionet e barazisë gjinore në disa prej raporteve të tij. Vetëm disa ministri mbledhin të dhëna të ndara sipas gjinisë për çështjet që lidhen me ndryshimet klimatike. Kjo përfshin Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe Agjencinë e saj të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (AZHBR)³⁹, por jo Njësitë e Mbrojtjes Civile. Përfshirja është më e madhe në nivel lokal, ku bashkitë po vendosin tregues gjinorë në sistemet e tyre të monitorimit të buxhetit.⁴⁰

Në vitin 2021, Shqipëria hartoi Strategjinë e re Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030⁴¹, ku ndër objektivat e vendosur, për herë të parë trajtohen çështjet e ndryshimeve klimatike dhe barazisë gjinore. "SKBGJ 2021-2030" përmban objektiva dhe masa që lidhen me fushat tematike të Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore III 2021-2025, të Bashkimit Europian (GEP III) të BE-së, si dhe "Adresimi i sfidave dhe shfrytëzimi i mundësive të ofruara nga tranzicioni në ekonominë e gjelbër, transformimin dixhital, ndryshimet klimatike dhe mjedisin." Në tërësi "SKBGJ 2021 - 2030" përbëhet nga katër synime kryesore strategjike, ku ka edhe objektiva specifike që pasqyrojnë nevojën për ndryshim ose shtimin e dimensioneve të reja drejt të cilave duhet të përqendrohet vëmendja për adresimin e duhur të çështjeve të barazisë gjinore, bazuar në zhvillimet më të fundit, si dhe duke marrë parasysh çështjet që lidhen me emergjencat civile, fatkeqësitë natyrore ose zonat

³⁵ The Green Climate Fund (GCF) – është fondi më i madh klimatik në botë, i mandatuar për të mbështetur vendet në zhvillim që t'i rrisin dhe realizojnë Ambiciet e Kontributeve të Përcaktuara Kombëtare drejt rrugëve me emetime të ulëta dhe rezistente ndaj klimës [About GCF | Green Climate Fund](#)

³⁶ Shqipëri: GIZ protagonist në zbatimin e ndryshimeve klimatike <https://www.dw.com/sq/shqip%C3%ABri-giz-protagonist-n%C3%AB-zbatim-e-ndryshimeve-klimatike/a-61741809>

³⁷ Instituti i Statistikave INSAT <http://www.instat.gov.al/en/sdgs/>

³⁸ Un Women Albania Country Gender Equality Brief 2020

<https://eca.unwomen.org/sites/default/files/Field%20Office%20Albania/Attachments/Publications/2020/12/CEGB%20Albania%20REPORT%201.pdf>

³⁹ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural <https://bujqesia.gov.al/en/>

⁴⁰ Njësoj si nr.38

⁴¹ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/06/30/400>

e reja deri tani të patrajuara ose shumë pak të adresuara në lidhje me barazinë gjinore (mjedisi dhe ndryshimet klimatike, dixhitalizimi, ekonomia dhe gjelbërimi, etj.).⁴²

Kuadri Ligjor

Në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, ekziston një kuadër ligjor solid dhe gjithashtu strategji për të adresuar në mënyrë specifike barazinë gjinore, me detyrime kombëtare dhe ndërkombëtare.

Niveli Ndërkombëtar

Detyrime jo shtrënguese:

- **KKKBNK - Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike**⁴³

KKKBNK hyri në fuqi më 21 mars 1994. Sot, ajo ka një anëtarësim pothuajse universal. 198 vendet që kanë ratifikuar Konventën quhen Palë në Konventë. Parandalimi i Ndërhyrjes "së rrezikshme" njerëzore në sistemin klimatik është qëllimi përfundimtar i KKKBNK. Shqipëria ratifikoi Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike në tetor të vitit 1994 dhe ajo hyri në fuqi më 1 janar 1995.

- **Protokolli Kioto**⁴⁴

Nga janari 2005 Shqipëria është gjithashtu Palë në Protokollin e Kiotos të KKKBNK. Ky protokoll angazhon vendet e zhvilluara, të listuara në Aneksin I, që të reduktojnë emetimet e gazrave serrë. Si një vend në zhvillim, Shqipëria mban statusin si Palë e papërfshirë në Aneksin I në të dy këto dokumente ligjore, që do të thotë se nuk ka objektiva ligjërishtrëngues për reduktimin e emetimeve.

- **Marrëveshja e Parisit**⁴⁵

Marrëveshja e Parisit është marrëveshja e parë universale, ligjërishtrënguese në të gjithë globin për ndryshimet klimatike, e miratuar në Konferencën e Parisit për Klimën (COP21) në dhjetor 2015. Shqipëria nënshkroi marrëveshjen më 22 prill 2016 dhe e ratifikoi atë më 21 shtator 2016.⁴⁶

⁴² IBID

⁴³ Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (United Nations Framework Convention on Climate Change) <https://unfccc.int/>

⁴⁴ Protokolli i Kiotos është një marrëveshje ndërkombëtare që synon të reduktojë emetimet e dioksidit të karbonit (CO₂) dhe praninë e gazeve serrë (GHG) në atmosferë. <https://www.investopedia.com/terms/k/kyoto.asp>

⁴⁵ Marrëveshja e Parisit https://ec.europa.eu/clima/eu-action/international-action-climate-change/climate-negotiations/paris-agreement_en

⁴⁶ <https://unfccc.int/node/28572>

- **Axhenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm)**⁴⁷

